



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 18/2021

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 15 qershor 2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 16/2021 të Kuvendit të OMK-së, datë 15 qershor 2021)

Neni 1

Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët të cilët ushtrojnë veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës

- I. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e punësuar në institucione publike dhe private, për mjekët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të punësuar, specialistët dhe mjekët nga Lugina e Preshevës, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);
- II. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e papunë nga kategoritë e cekura në paragrafin I (mjekët shtetas kosovarë, specialistë pa kontratë pune dhe mjekët e papunë na Lugina e Preshevës) në shumë prej 40.00 (katërdhjetë) € (euro);
- III. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e rinjë shtetas kosovar dhe mjekët e rinjë nga Lugina e Preshevës, të cilët kryejnë provimin e licencës për herë të parë gjatë vitit kalendarik përkatës pas datës 1 korrik dhe anëtarësohen në OMK, në shumë prej 20.00 (njëzetë) € (euro);

IV. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi kosovare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit dhe dëshirojnë vullnetarisht të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);

V. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi të huaj në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) € (euro);

VI. Lirohen nga detyrimi për të paguar kuotën e anëtarësisë vjetore në OMK, mjekët e pensionuar që nuk ushtrojnë veprimtarinë mjekësore, dhe të cilët e dëshmojnë përmes vërtetimit të ATK-së se nuk kanë deklaruar të hyra për vitin kalendarik kur bëhet pagesa e kuotës së anëtarësisë.

VII. Kuota e anëtarësisë në OMK për vitin 2022 për mjekët shtetas të huaj, do të përcaktohet në bazë të parimit të reciprocitetit, varësisht nga shteti prej nga vijnë. Kjo dispozitë do të fillojë së zbatuari nga data 1 janar 2022.

Neni 2

Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësimit vjetor

I. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore publike do t'i bëhet ndalesa automatike e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore me pagën e muajit shkurt të vitit kalendarik përmes sistemit të pagave-Payroll, ose përmes sistemit të pagesave të OMK-së jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik.

II. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore private, mjeku i pensionuar që ushtron veprimtarinë mjekësore si i punësuar, specialisti dhe mjeku i punësuar nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

III. Mjeku shtetas kosovarë, mjeku i pensionuar që nuk ushtron veprimtarinë mjekësore, specialisti pa kontratë pune dhe mjekët e papunë nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

IV. Mjeku qytetar jo Kosovarë i cili ushtron veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në

OMK ta bëjë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

V. Mjeku me shtetësi kosovare i cili ushtron veprimtarinë mjekësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës e që vullnetarisht anëtarësohen në OMK, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

Neni 3

Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësimit

I. Të gjithë mjekët që nuk i kryejnë obligimet sipas këtij Vendimi, lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë, Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim i OMK-së, përmes Vendimit të formës së prerë do të ndërpres anëtarësimin në OMK sipas Nenit 15 paragrafi me nenparagrafin 1.4. të Statutit të OMK-së.

Neni 4

Hyrja në fuqi

I. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 15 qershor 2021

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sc

